



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 13.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.02.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eing-Com" për aktivitetin: "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-5173-121 nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekono**"Eing Com"** e datës 11.02.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" me Nr.616 18 5173 121, Nr. Brendshëm 616 18 083 121 211 kundër *Njoftimit për anulim të aktivitetit*, të datës 06.02.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Njoftimi për anulim të aktivitetit i publikuar me datë: 06.02.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit për anulim të aktivitetit*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **"Eing Com"** me datë 06.02.2019 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me shporta xhepi dhe ulëse" me Nr.616 18 5173 121 Nr. Brendshëm 616 18 083 121".

Autoriteti Kontraktues, me datë 13.02.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Pretendimi se Vendimi i AK-se është në kundërshtim me Vendimin e OSH numër 488/18 dhe 694/18, pasi që një konstatim i tillë ekziston në Vendimi nr.488/18, ndërsa në Vendimin tjetër

janë paraqitur arsyet për anulimin e aktiviteteve të prokurimit sipas dispozitave ligjore dhe askund nuk ka cekur se në rastin konkret nuk është tejkaluar vlera e parashikuar, pasi që është e qartë se çmimi për një copë(njësi) nuk mund ta tejkaloj vlerën e parashikuar për tërë projektin dhe si duket këtë e ka vërejtur edhe Paneli Shqyrtrues dhe nuk e ka përsëritur të njëjtën në Vendimin e dytë;

-Lidhur me pretendimin tjetër për të drejtën tonë për të kërkuar çmime tjera lidhur me artikujt nga tenderi qëndron në ekspertizat paraprake sipas të cilave AK-ja nuk ka bërë hulumtim të tregut lidhur me çmimin dhe edhe siku të mos qëndronte ua përkujtoj se në asnjë rast, respektivisht në asnjë procedurë AK-ja nuk lirohet nga përgjegjësia, por përkundrazi ka obligim ligjor që të luaj rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, garancionet dhe i njëjti duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut (referoju nenit 35.3 të LPP-ik)

-Lidhur me pretendimin se nuk u është ofruar çasje në këto dokumente ju sqaroj se ato kanë të bëjnë me hulumtimet tona dhe nuk janë për publikun, përpos për organet kompetente: OSHP, KRPP, AKK, etj. dhe lidhur me këtë do të duhej të parashtroni një pyetje për veten tuaj: Ku e muarët ju të drejtën në sqarimin e datës 06.11.2018 që të deklaroni se çështja e shpërndarjes së çmimeve në paramasë është çështje e kompanisë dhe nuk duhet ti sqarohet AK-se, ndërsa sipas jush AK-ja paska obligim të ofroj sqarime dhe informata për ju?;

-Pretendimi juaj se AK-ja ka bërë krahasimin e ofertave në kundërshtim me dispozitat ligjore ua sqarojmë prap se AK-ja ka analizuar çmimet tuaja në raport me përqindjet e parashikuara nga vetë AK-ja dhe nuk ka bërë krahasim me ofertat tjera siqë pretendoni ju.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet detale nga Vendimi për anulim ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit